

..

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, Mr.sc.Muhamet Rexha dhe Emine Kaçiku, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit E. M. nga komuna e Vushtrrisë, të cilin e përfaqëson N. B., avokat nga Vushtrria, kundër të paditurës KS “K. e R.” me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit jo material dhe material, duke vendosur përkitazi me revizionin e të autorizuarit të paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.2192/2013 datë 10.5.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur, më 16 shkurt 2017 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të autorizuarit të paditësit E. M. nga fshati ... – avokatit N. B., nga Vushtrria, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 2192/2013 datë 10.5.2016.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit, të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr. 2192/2013 datë 10.5.2016, pranohet ankesa e të paditurës, KS “K. e R.” me seli në Prishtinë, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, C.nr. 300/2012 datë 30.5.2013, ashtu që refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit E. M. nga komuna e Vushtrrisë me të cilin ka kërkuar që të obligohet e paditura KS “K. e R.” me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit jo material, paditësit E. M. t’ia paguajë shumën totale prej 10.490 € dhe atë në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 2.750 €, frikën e pësuar shumën prej 1.300 €, shëmtim trupor shumën prej 2.000 €, ndihmën e personit të tretë shumën prej 200 €, ushqim të përforcuar shumën prej 240 €, zvogëlimin e aktivitetit jetësor dhe punës shumën prej

4.000 € dhe të obligohet e paditura që në emër të shpenzimeve procedurale paditësit t'ia paguajë shumën totale prej 1.677 € dhe atë për shpenzimet procedurale në shkallën e parë sipas lëndës C.nr. 228/2008 shumën prej 709 €, për gjashtë seanca të përfaqësimit në procedurën e rigjyimit të paditësit, shumën prej 730,08 € (për secilën seancë nga 121.68 €), në emër të përpilimit të revizionit shumën prej 208 €, në emër të pagesës së taksës gjyqësore për revizion shumën prej 30 € dhe të obligohet e paditura që në emër të shpenzimeve gjyqësore përpilimit të këtij aktgjykimi, gjykatës t'ia paguajë shumën prej 25 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm si e pabazuar. Me pjesën III të dispozitivit paragrafi IV i dispozitivit të aktgjyimit të atakuar, nuk është shqyrtuar. Është vendosur që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjyimit të gjykatës së shkallës së dytë revizion me kohë ka paraqitur i autorizuari i paditësit për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë apo të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjyimit të goditur në bazë të dispozitës së nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se në aksidentin e komunikacionit që ka ndodhur më datë 3.12.2001 në Vushtrri, paditësi në cilësinë e bashkë udhëtarit ka pësuar lëndime të rënda trupore.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka konstatuar se e paditura KS "K. e R.", ka legjitimitet pasiv për të qenë e paditur në këtë çështje juridike. Nga njoftimi i BQK-së datë 7.7.2010 del konstatimi se ish KS "K." i është revokuar licenca dhe është emëruar likuidatori, kështu që e paditura KS "K. e R.", e ka blerë vetëm biznesin, ndërsa dëmet për polisat jo aktive i ka marrë likuidatori i ish KS "Kosova". Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë polisat aktive që kanë qenë të ish "K." ka marrë tani e paditura KS "Kosova e Re" dhe se polisa me nr. ..., ka pasur afat të vlefshëm deri më datën 16.9.2002 dhe sipas vlerësimit të asaj gjykate e njëjta polisë në momentin e blerjes së biznesit dhe polisave aktive

të të paditurës nga ish “K.”, ka qenë aktive dhe në mbështetje të këtij fakti gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se e paditura KS “K. e R.” ka përgjegjësi për kompensimin e dëmit paditësit në bazë të nenit 18 par. 1 dhe nenit 32 të Ligjit mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga autopërgjegjësia e Kosovës e lidhur me nenin 897 par. 1 të LMD. Lartësinë e kompensimit të paditësit e ka caktuar duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertëve, sipas të cilëve me rastin e aksidentit paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore, të përshkruar më hollësisht në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, përfshirë këtu edhe zvogëlimin e aktivitetit jetësor dhe aftësisë së punës së paditësit, të cilin e ka vlerësuar me shkallën 25%. Në bazë të kësaj gjendje të vërtetuar gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën e ankimimit ka gjetur se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në bazë të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë në kohën kur ka ndodhur aksidenti më datën 13.12.2001 në të cilin aksident lëndime trupore ka pësuar paditësi dhe dy persona tjerë kanë vdekur në atë kohë KS “K. e R.” nuk ka ekzistuar, atëherë ka qenë aktive dhe ka ekzistuar KS “K.”, ndaj të cilës është hapur procedura e likuidimit në muajin nëntor të vitit 2001. Andaj, detyrimi i kompensimit të dëmeve nga aksidenti i datës 13.12.2001 ka qenë i KS “Kosova” ndërsa të paditurës “Kosova e Re”, i mungon legjitimiteti pasiv në këtë çështje juridike dhe nuk mund të jetë obliguese për kompensimin e dëmit për paditësin.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka miratuar si të bazuar ankesën e të paditurës duke ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktgjykimi i goditur nuk përmban të meta që kishin me ndikuar në ligjshmërinë e saj lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë të paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm përfundimin e gjykatës së shkallës së dytë përkitazi me ekzistimin e legjitimacionit pasiv të paditurës për dëmshpërblimin e këtij dëmi, pasi që automjeti me të cilin është shkaktuar ky dëm nuk ka qenë e siguruar tek e paditura. Automjeti me të cilin është shkaktuar ky aksident në të cilën edhe paditësi në cilësinë e bashkë udhëtarit ka pësuar lëndime të rënda trupore, në momentin e aksidentit ka qenë i siguruar në Kompaninë e Sigurimeve KS “K.” ndaj të cilit është hapur

procedura e likuidimit në nëntor të vitit 2001 me vendimin e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të (Kosovës tani Banka Qendrore e Republikës së Kosovës) dhe ka mbaruar më 12 maj të vitit 2009, ku BQK ka miratuar raportin përfundimtar në këtë kompani. KS “K. e R.” Kështu që , të paditurës i mungon legjitimiteti pasiv , nga se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më datë 13.12.2001 , dhe në atë kohë e paditura KS “K. e R.” nuk ka ekzistuar , sepse kjo kompani është licencuar më datën 25.4.2002. Nga kjo rezulton se e paditura KS “K. e R.” nuk është suksesore përkatësisht trashëgimtare e KS “K.” në likuidim dhe nuk ka obligim për kompensimin e dëmit eventual që ka ndodhur para datës 25.4.2002.

Gjykata e shkallës së dytë drejt ka vlerësuar se e paditura KS “K. e R.” mund të jetë e detyruar për kompensimin eventual për dëmet që kanë ndodhur nga data 5.4.2002, konkludim i cili rrjedh nga marrëveshja për transferimin e protofolit në mes të KS “Kosova” dhe K. C. G., protokolluar më datën 2.5.2002, ku në nenin 2 të kësaj thuhet se transferi bëhet komercialist i vlefshëm më datën 5.4.2002, në bazë të formularëve të përgatitur nga autoritetet bankare i pagesave të Kosovës, bilanci financiar i përgatitur nga KIDS më 31.3.2002 dhe i inspektuar e certifikuar nga eksperti këshillues i ABKS. Nga të gjitha këto konkludohet se dëmi dhe detyrimi që ndodhin pas datës 5.4.2002 janë detyrime të KS “K. e R.” , pasi që edhe në ujdinë jashtë gjyqësore rezulton se KS “K. e R.” përkatësisht nga administratori i falimentimit janë kompensuar familjarët e personave të vdekur në aksidentin e datës 13.12.2001.

Afati për parashtrimin e kërkesave të kreditorëve të KS “Kosova” në likuidim, ka qenë e përcaktuar me nenin 71.11 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/25, sipas të cilës “kërkesat kundër Kompanisë së Sigurimit apo ndërmjetësuesit të sigurimit futen në dosje të adminitorit ligjor brenda 90 ditësh pas anulimit të licencës së kompanisë së sigurimit apo ndërmjetësimit të sigurimit”. Me vendimin e Autoritetit bankar të Pagesave procedura e likuidimit nda KS “K.” është hapurën muajin nëntor 2001 kështu që kreditorët kërkesat e tyre kanë qenë të obliguara që ti paraqesin në afatin prej 90 ditësh, pas anulimit të licencës së kompanisë së sigurimit, apo ndërmjetësuesit të sigurimit. Në situatën konkrete për pagesën e dëmit eventual të shkaktuar paditësit është administratori i likuidimit dhe atë nga mjetet e likuidimit të ish “K.” e likuiduar nga ish autoriteti bankar i pagesave tani BQK.

Përndryshe, për arsyet e dhëna nga ana e gjykata e shkallës së dytë dhe arsyeve të dhëna nga kjo Gjykatë, nga aspekti i të drejtës materiale, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i ligjshme.

Së këndejmi, pretendimet në revizion se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika (n) të LPK, pasi që nuk janë dhënë arsyet për faktet vendimtare lidhur me legjitimitetin pasiv të paditurës për kompensimin e dëmit pasi që vetë përfaqësuesi i të paditurës ka ofruar dokumentacion që argumentojnë faktin se e paditura ka blerë portofolin e polisave aktive dhe polisa e paditësit ishte aktive në momentin e transferimit të KS "K. e R.". Pretendimet e tilla kjo Gjykatë i cilësoj si të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj për faktin se aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me këto shkelje, përmban arsye faktike dhe juridike për të gjitha faktet relevante që janë të pranueshme edhe për këtë Gjykatë.

Parashtrimet në revizion se në momentin e shkakimit të aksidentit paditësi ka qenë në gjendje të rëndë shëndetësore dhe nuk ka pasur mundësi të inicioj procedurë për realizimin e të drejtës në kompensim dhe pa përfunduar procedura penale, për këtë arsye paditësi nuk mund të pësoj dëm për mos njohjen e ligjit pasi që në rastin konkret janë shkelur konventat mbi të drejtat dhe liritë e qytetarëve në dëm të paditësit .Parashtrimet e këtilla kjo Gjykatë nuk i shqyrtoj pasi që në thelb kanë të bëjnë me vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike për të cilat shkaqe nuk mund të paraqitet revizioni (214.2 të LPK).

Nga sa u tha më sipër e me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr. 224/2016, më 16 shkurt 2017

Kryetare e kolegjit,
Gyltene Sylejmani